

VENDIM
Nr. 15, datë 16.1.2025

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “REBESOL” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13, dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 117 prot., datë 14.1.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Rebesol’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Rebesol” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855 prot., datë 2.9.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet prodhues 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 184, datë 12.9.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.9.2024 dhe 14.9.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 23.9.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 1927 prot., datë 16.9.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, me shkresën nr. 1855/3 prot., datë 30.9.2024, ERE e ka njoftuar për vendimin nr. 184/2024 dhe i ka evidentuar informacionin/dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi. Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855/5 prot., datë 11.10.2024, nga analizimi i së cilës ka rezultuar se ka ende informacion/dokumentacion që nevojitet të plotësohet, ndaj me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 218, datë 16.10.2024, është vendosur zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit me 30 (tridhjetë) ditë.

- Me shkresën me nr. 1855/7 prot., datë 24.10.2024, dhe nëpërmjet *email*-it rikujtesë protokolluar me nr. 1855/8 prot., datë 1.11.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë mbi vendimmarrjen e Bordit për zgjatjen e afatit dhe për sa mbetet ende pa plotësuar.

- Ndërsa, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855/8 prot., datë 11.11.2024, dhe shkresën nr. 1855/9 prot., datë 11.11.2024, shoqëria ka përcjellë një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, ndaj ERE, nëpërmjet *email*-it protokolluar me nr. 1855/10 prot., datë 12.11.2024, i ka sjellë në vëmendje dokumentacionin e rezultuar ende të paplotësuar të këtij aplikimi.

- Shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855/11 prot., datë 13.11.2024, e me qëllim shqyrtimin e këtij dokumentacioni dhe/ose zhvillimin e një korrespondence të mundshme me shoqërinë, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 14.11.2024, u vendos zgjatja deri jo më vonë se data 26.1.2025 i afatit të vendimmarrjes së Bordit në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Rebesol” sh.p.k.

- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1855/13 prot., datë 27.11.2024, me anë të së cilës i bëri me dije vendimin e marrë nga Bordi i ERE-s dhe i solli në vëmendje informacionin/dokumentacionin që mbetet ende pa plotësuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855/14 prot., datë 10.12.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues, i cili gjendet në pjesët takuese të këtij relacioni.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat: “a”, “b” dhe “c”; dhe për pikën 2.1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Rebesol” sh.p.k.:

- ka nënshkruar me MIE-n, kontratën nr. 10516 rep., nr. 4878 kol., datë 28.12.2023;

- ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., marrëveshjen e lidhjes së re nr. 9505/2 prot., datë 13.10.2023, për lidhjen e centralit fotovoltaiik me rrjetin e shpërndarjes;

- është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar më datë 3.12.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të ndërtuar impiantin fotovoltaiik me fuqi 2 mw, nga shoqëria “Rebesol” sh.p.k.

- Në nenin 4 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, nr. 10516 rep., nr. 4878 kol., datë 28.12.2023, specifikohet se ajo lidhet për një afat 49-vjeçar, nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje. ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare për panelet fotovoltaike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9, të kontratës nr. 10516 rep., nr. 4878 kol., datë 28.12.2023, të nënshkruar me MIE-n, shoqëria duhet të fillojë punimet brenda 90 ditëve nga pajisja me të gjitha lejet (me të cilat nuk është pajisur akoma) dhe se do të vendosë në punë centralin brenda 12 muajve nga pajisja me këto leje. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të kësaj kontrate.

- Rezulton se shoqëria ka një VNM të vlefshme, deri më datë 3.12.2026, ndaj vlerësohet që në kuadër të mbikëqyrjes shoqëria të raportojë çdo 3 (tre) muaj në ERE, në lidhje me fillimin e punimeve brenda këtij afati.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Rebesol” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet prodhues 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të përcaktuara nga kontrata me MIE-n.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Rebesol” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a. dhe “FTL” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti